



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

KËSHILLI KONSULTATIV
QEVERISJE QENDRORE - VETËQEVERISJE VENDORE

Nr 191 prot

Tiranë, më 9.04 2025

VENDIM


Nr. 2 datë 9.04 2025

PËR

**MIRATIMIN E PROJEKTAKTEVE OBJEKT KONSULTIMI NË MBLEDHJEN E
KËSHILLIT KONSULTATIV, QEVERISJE QENDRORE – VETËQEVERISJE
VENDORE TË DATËS 09/04/2025**

Këshilli Konsultativ bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe në VKM nr.244, datë 17.4.2024 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, pas shqyrtimit të projektakteve të mëposhtme, të mbledhjes së datës 09.04.2025 vendosi:

1. Për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.926, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar”, propozuar nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre shprehën dakordësinë në parim me projektvendimin.
2. Për projekt-urdhërin e Kryeministrit “Për ngritjen e Task-Forcës Ndërinstitucionale për Sezonin Turistik 2025”, propozuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre shprehën dakordësinë në parim me projekt-urdhërin.



Z. Arbjan MAZNIKU
Ministër Shteti për Pushtetin Vendor

Z. Aldrin DALIPI
Kryetar/Bashkëkryetar
Shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë

